

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Frosina Sylejmani anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj SH.H. nga Prishtina, kundër të paditurit H.S. nga Mitrovica, për shkak të pasurimit të pabazë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.66/14, të datës 18.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditurit H.S. nga Mitrovica, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.66/14, i datës 18.11.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin C.nr.66/14, të datës 18.11.2014, në pjesën e parë të dispozitivit e ka detyruar të paditurin që brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën prej 160 euro, në emër të pasurimit pa bazë në llogarinë rrjedhëse me nr. 1000430070003622, të llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën definitive, ndërsa me pjesën tjetër të dispozitivit e ka detyruar të paditurin që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditëses shumën prej 15 euro dhe për përpilimin e aktgjykimit shumën prej 15 euro, më gjerësisht sikurse në aktgjykimin e atakuar.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 10.02.2014, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, paditësja ka parashtruar padi, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën prej 160 euro, në emër të pasurimit pa bazë në llogarinë rrjedhëse me nr. XYZXYZXYZ, të paditëse, të llogaritur nga dita e

pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe të detyrohet i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditëses shumën prej 15 euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.66/14, të datës 18.11.2014, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas administrimit të provave në shqyrtimin kryesor dhe atë: raportin e vdekjes për të ndjerën F.S. të datës 04.06.2012, çertifikatën e vdekjes për të ndjerën të lëshuar me datë 23.03.2012, kërkesën për hapje të llogarisë bankare, të datës 24.06.2003, kortonin me nënshkrimet e deponuara, mbylljen e llogarisë së datës 04.06.2012, vërtetohet fakti se tani e ndjera F.S. ka qenë përfituese e skemës sociale, ndërsa të hollat në emër të saj i ka tërëhjekur i autorizuari-këtu i padituri H.S., ndërsa është vërtetuar edhe fakti se tani e ndjera ka vdekur me datë 02.03.2012, ndërsa i autorizuari i saj i ka tërëhjekur të hollat me datë 23.04.2012 dhe 22.05.2012 dhe atë dy muaj pas vdekjes së saj, për çka këtu i padituri konform nenit 2010 parag.1 të LMD-së ka fituar pa bazë, për çka edhe kjo gjykatë ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se ekziston detyrimi juridik civil i të paditurit ndaj paditëses, për kthimin e shumës së cekur në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Për sa i përket pretendimeve ankimore të paditurit rreth konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, gjykata fare nuk i vlerësoi të njëjtat. Kjo për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me kontest të vlerës së vogël, e që konform nenit 491 parag.1 të LPK-së, aktgjykimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, por jo edhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (edhe pse gjykata e shkallës së parë ka pasur për detyrim ligjor që konform nenit 491 parag.2 të LPK-së, në aktgjykimin e atakuar t'i përmendë shkaqet në bazë të të cilave mund të bëhet ankimi).

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në

mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.772/15, datë 04.04.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka